

DE 6 17 / 2025



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Bazuar në Ligjin e punës Nr.03/L-212 dhe Udhëzimin Administrativ MFPT-Nr.01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në Sektorin Publik dhe me rekomandim të komisionit sipas vendimit Nr.603/2025, u.d Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me datë 17 mars 2025, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Që të Anuloj procesin e rekrutimit për Pozitën e Drejtorit Menaxhues të NSH Inex Sharr Pllanina Brezovica me numër ref.1/2025
- II. Vendimi Hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të vendimit.

ARSYETIM

Agjencia Kosovare e Privatizimit – Divizioni i Kontrollës dhe Administrimit të Direkt me datë 21 shkurt 2025, ka shpallur konkurs për pozitën Drejtor Menaxhues të NSH Inex Sharr Pllanina Brezovica

Pas përfundimit të procedurës së aplikimit komisioni në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve sipas vendimit DE.603/2025 ka ardhur në përfundim se shpallja e konkursit publik për pozitën Drejtor Menaxhues të NSH Inex Sharr Pllanina Brezovica duhet te jete e riformeluar/plotësuar me të dhëna shtesë për arsye të transparencës dhe informimit publik. Komisioni konkludon se kjo ka qenë arsye se ka pasur numër të vogël aplikantësh të interesuar për aplikim dhe që plotësojnë kushtet për tu kualifikuar për procesin e mëtuftjeshëm të intervistimit.

Si rrjedhojë e këtij procesi, Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi çdo kandidat i cili nuk është i pakënaqur me rezultatet e verifikimit paraprak, mund të ushtroj ankesë ndaj vendimit, pranë komisionit të Ankesave në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit brenda tre (3) ditëve nga data e pranimit të vendimit.

Prishtinë, më 17 mars 2025



Ibrahim Gjylderan
u.d. Drejtor Ekzekutiv
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Vendimi t'i dërgohet:

Departamentit të Koordinimit Regjional dhe Operativës, Divizionit i Kontrollës dhe Administrimit të Direkt dhe Arkivit të Agjencisë.

1 / 1

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës